

UDHËZIM
Nr. 10, datë 3.5.2016

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014,
“PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË VEÇANTË TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË
PRODHUESVE BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI VLERËN E
SHTUAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në fund të pikës 2, të nenit 5, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Për aktivitetin prodhues bujqësor që kryhet në të njëjtin vend/adresë (tokë bujqësore ose adresë ku kryhet veprimtaria bujqësore/blegtorale) në pronësi ose në përdorim, ky vërtetim, për qëllime të pajisjes me NIPT, lëshohet vetëm në emër të një fermeri.”

2. Shkronja “a” dhe “b” në pikën 4, të nenit 5, ndryshojnë me përmbajtjen e mëposhtme:

“Për pajisjen me NIPT të fermerit janë të detyrueshme këto të dhëna:

a) të dhënat e identifikimit të fermerit, adresa e banimit, kontakte të personit;

b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore. Për të njëjtin vend të veprimtarisë /adresë të ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore, pajiset me NIPT, vetëm një fermer i cili ka në pronësi ose në përdorim dhe ushtron veprimtarinë në këtë vend.”

3. Fjalja e dytë në pikën 3, të nenit 9, “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar” shfuqizohet dhe pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Personi i tatueshëm, blerës me qëllim, që të ketë të drejtën e zbritjes së normës së kompensimit të TVSH-së të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, për transaksione mbi 30 000 lekë, është i detyruar të kryejë likuidimin e vlerës së faturës nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare ose nëpërmjet bankës, nëse vlera e transaksionit nuk e kalon shumën prej 150 000 lekësh dhe nëpërmjet likuidimit nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit, për transaksione, vlera e të cilit është më e madhe se 150 000 lekë, siç përcaktohet në nenin 59 të ligjit, “Për procedurat tatimore në RSH”.

Për transaksione sipas vlerës totale të faturës deri në 30 000 lekë, likuidimi me para në dorë vërtetohet me dokumentet përkatëse të kontabilitetit për dokumentimin e pagesave, duke pasur parasysh kushtin se brenda së njëjtës ditë, me të njëjtin fermer, nuk lejohet të kryhet më shumë se një transaksion deri në këtë vlerë.

6. Personi i tatueshëm blerës që eksporton produkteve e blera nga fermerët sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së u nënshtrohet rregullave të përcaktuara në nenin 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Personat e tatueshëm blerës që karakterizohen me risk zero sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave, rimbursohen për TVSH-në, automatikisht, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”

4. Në nenin 10, pas pikës 4 shtohen pikat 5, 5.1, 5.2, 5.3, 5.4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Personi i tatueshëm blerës i produkteve të fermerit, i cili për zbatimin e kësaj skeme ngarkohet të lëshojë faturë tatimore, jo vetëm për shijet që kryen, por edhe faturë në emër të fermerit si blerës i produkteve të tij, lejohet të përdorë faturë tatimore kompjuterike me numër serial unik dhe të papërsëritshëm të printuar nga sistemi i tij i regjistrimeve.

5.1 Për këtë qëllim, personi i tatueshëm duhet të paraqesë:

a) Një kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, në të cilën të tregojë se sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm për çdo transaksion dhe që lëshon një numër të konsiderueshëm faturash;

b) Modelin e faturës kompjuterike që kërkon të përdorë, model i cili duhet të përmbajë të gjitha të

dhënat në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij neni.

Drejtoria Rajonale Tatimore, sigurohet që fatura tatimore kompjuterike përmban të gjitha të dhënat e nevojshme dhe brenda 7 ditëve, një kopje të kërkesës, modelin e faturës tatimore kompjuterike dhe opinionin e saj e dërgon në Drejtorinë e Për-gjithshme të Tatimeve.

5.2 Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 7 ditësh miraton përdorimin e faturës tatimore kompjuterike, sipas modelit të kërkuar dhe njofton personin e tatueshëm dhe drejtorinë rajonale tatimore, e cila i dorëzon personit të tatueshëm zyrtarisht diapazonin e numrave serialë që duhet të përmbajë çdo faturë. Çdo faturë e lëshuar sipas modelit të miratuar përmban detyrimitsh shënimin, “Përdorimi i kësaj fature është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me shkresën nr. ..., datë...”.

5.3 E drejta për të përdorur modelin e miratuar të faturës tatimore kompjuterike për personin e tatueshëm fillon pasi është pajisur me diapazonin e numrave serialë që duhet të përmbajë çdo faturë. Numri serial është unik dhe i papërsëritshëm për çdo faturë të lëshuar.

5.4 Për çdo ndryshim në modelin, përmbajtjen, formatin e faturës kompjuterike për të cilën është miratuar e drejta e përdorimit, personi i tatueshëm duhet të kërkojë miratim të modelit të ndryshuar të faturës tatimore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE

Arben Ahmetaj